



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR GJIROKASTËR

ANALIZA VJETORE E GJYKATËS SË RRETHIT GJYQËSOR

GJIROKASTËR PËR VITIN 2021

Dokumenti Analiza Vjetore e Gjykatës përfaqëson në mënyrë të përmbledhur analizën e punës së kryer dhe performancën e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë gjatë vitit kalendarik 2021, parashtrohet njëkohësisht problematikat e konstatuara gjatë këtij viti përse i takon funksionimit të institucionit në tërësi si dhe sfidat për të ardhmen.

I. VEPRIMTARIA GJYQËSORE

1. Ngarkesa dhe lloji i çështjeve gjyqësore.
2. Tendenca e ngarkesës me çështje.
3. Likujdimi/përfundimi i çështjeve.
 - a. Çështjet penale themeli.
 - b. Kërkesa penale.
 - c. Kërkesa penale në seancë paraprake.
 - d. Çështjet civile.
 - e. Kërkesat civile (çështje civile pa palë kundërshtare)
4. Ngarkesa me çështje për gjyqtar.
 - a. Delegimet e gjyqtarëve.
5. Shpejtësia në gjykim.
6. Heqjet dorë nga gjykimi i çështjeve.
7. Përfundimet e gjyqtarëve nga gjykimi i çështjeve.

II. MENAXHIMI I LËVIZJES SË ÇËSHTJEVE GJYQËSORE

1. Mbikqyrja e progresit të çështjeve.

III. MENAXHIMI ADMINISTRATIV I GJYKATËS

1. Organika dhe burimet njerëzore.
2. Teknologjia e informacionit.
3. Kryesekretaria dhe ofrimi i shërbimeve nga administrata gjyqësore.
4. Aksesit, transparenca, marrëdhëniet me publikun dhe median.
5. Çështjet e ruajtjes dhe sigurisë në gjykatë.
6. Administrimi i fondeve publike.
7. Marrëdhëniet me institucionet e tjera.

IV. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

HYRJE

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë ushtron funksionin e saj në zbatim të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe Ligjit Nr. 98/2016, “Për Organizimin dhe Funksionimin e Pushtetit Gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”. Kjo gjykatë për vitin gjyqësor 2021, është përpjekur të plotësojë me korrektësi dhe cilësi detyrat që i ngarkon ligji për të ushtruar veprimtarinë gjyqësore në funksion të dhënies së drejtësisë.

Në raportin analizues të përpiluar do të trajtojmë me hollësi veprimtarinë gjyqësore në tërësi, të gjyqtarëve në veçanti si dhe arritjet dhe përmirësimet që duhet të bëhen për vitin 2022.

Të dhënat e trajtuara në këtë analizë janë marrë nga të dhënat statistikore që disponon Zyra e Kancelarisë si dhe të dhënat që dërgohen në Ministrinë e Drejtësisë dhe Këshillin e Lartë Gjyqësor.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë me qendër në Gjirokastrë, e cila shtrin veprimtarinë në Qarku Gjirokastrë (Bashkitë Gjirokastrë, Libohovë, Dropull) dhe Qarku Tepelenë (Bashkitë Tepelenë, Memaliaj), ka në organikën e saj 6 gjyqtarë. Viti 2021 e gjeti gjykatën me 5 gjyqtarë, por gjatë këtij viti, për arsye të shkarkimit nga KPK dhe daljes në pension të një gjyqtari, janë larguar edhe 2 gjyqtarë. Kështu që në fund të vitit 2021, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, zhvillimet e seancave gjyqësore, përballoheshin nga vetëm 3 gjyqtarë.

Në gjykatë, për vitin e kaluar me vështirësi kanë funksionuar seksionet penal dhe civile, për shkak të numrit të kufizuar të gjyqtarëve, është kërkuar delegimi i gjyqtarëve nga gjykata të tjera. Në muajin Janar të vitin 2022 pranë Gjykatës të Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë është vendosur transferim i përkohshëm me pëlqim, të gjyqtarit Z.Gjergji Baçi, i cili ishte gjyqtar i emëruar pranë Gjykatës të Rrethit Gjyqësor Përmet.

Gjykata nuk është e ndarë në dhoma civile apo penale për shkak të numrit të vogël të gjyqtarëve.

Të katërt gjyqtarët të cilët janë në përbërjen aktuale, gjykojnë çështje penale dhe civile, përfshirë edhe kërkesat e seancës paraprake. Tre nga gjyqtarët, Blerta Çibuku (Marku), Suela Dashi dhe Gjergji Baçi në mbështetje të nenit 282 të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur, të miratuar me ligjin nr.37/2017, dhe Udhëzimit nr.79 datë 30.05.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, me Vendim të Këshillit të Gjykatës, janë caktuar si gjyqtarë të specializuar për çështjet penale me të mitur, për gjykimin e çështjeve penale me të mitur në konflikt me ligjin ose të mitur viktimë nga vepra penale.

Në fokus të punës së gjykatës ka qënë ofrimi i shërbimeve administrative me qëllim rritjen e besimit të publikut tek institucioni dhe duke ju siguruar qytetareve akses të vazhdueshëm dhe informacion të plotë mbi veprimtarinë e saj.

I. VEPRIMTARIA GJYQËSORE

1. NGARKESA DHE LLOJI I ÇËSHTJEVE GJYQËSORE.


Gjatë vitit 2021 në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë janë paraqitur për shqyrtim në total 3041 çështje (të natyrës penale, penale-administrative, civile dhe familjare). Në numrin e çështjeve për shqyrtim përfshihen 657 çështje të mbartura nga viti 2020 dhe 2384 çështje të regjistruara të reja në vitin 2021.

Nga totali i çështjeve për shqyrtim, për 2215 çështje ka përfunduar gjykimi në vitin 2021, ndërsa 826 çështje kanë mbetur papërfunduar dhe janë mbartur për gjykim në vitin 2022, sipas tabelës 1.

Tabela.1

Volumi i Çështjeve për vitin 2021	Numri i çështjeve
Çështje të gjykuara (përfunduara)	2215
Çështje të mbartura nga viti 2020 në vitin 2021	657
Çështje të mbartura nga viti 2021 në vitin 2022	826
Çështje të regjistruara të reja	2384

Grafiku. 1



Nga totali i çështjeve të gjykuara rezulton se:

1. Në kategorinë penale, ka përfunduar gjykimi për një total prej 1141 çështje. Në këtë numër përfshihen çështje penale themeli, penale të posaçme, kërkesa penale-administrative, kërkesa

penale gjatë hetimeve paraprake, në seancë paraprake dhe kërkesa penale gjatë fazës së ekzekutimit të dënimit.

2. Në kategorinë civile dhe familjare ka përfunduar gjykimi për 1074 çështje.

Nga analiza e të dhënave të mësipërme, rezulton se ngarkesa me çështje gjyqësore është e lartë për organikën prej vetëm 4 gjyqtarë (aktualisht) të gjykatës.

Numri i çështjeve penale është e lartë për shkak se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, mbulon kërkesat e të dënuarve në IEVP-Tepelenë, IEVP-Sarandë, si dhe mbulohen edhe kërkesat e të dënuarve në paraburgimin e IEVP-Tepelenë.


2. TENDENCA E NGARKESËS ME ÇËSHTJE.

Për të parë tendencën e ngarkesës le ti referohemi tabelat e çështjeve për 5 vitet e fundit, duke bërë edhe krahasimet përkatëse:


Tabela.2

	Çështje të regjistruara për gjykim	Çështje të gjykuara	Çështje të mbartura
Viti 2017	1867	1564	303
Viti 2018	1803	1365	438
Viti 2019	1995	1550	445
Viti 2020	3145	2246	899
Viti 2021	3041	2215	826

Grafiku.2



Grafiku.3




Raporti i numrit të çështjeve regjistruara në total (përfshirë të mbartura nga viti paraardhës) në 5 vitet e fundit:

Tabela. 3

Çështje të regjistruara në total (penale dhe civile)				
Viti 2017	Viti 2018	Viti 2019	Viti 2020	Viti 2021
1867	1803	1995	3145	3041

Grafiku.4




Numri i çështjeve të gjykuara në vitet e fundit:

Tabela.4

Çështje të gjykuara në total (penale dhe civile)				
Viti 2017	Viti 2018	Viti 2019	Viti 2020	Viti 2021
1564	1365	1550	2246	2215

Të dhënat statistikore për tendencën e ngarkesës me çështje për vitet e fundit tregojnë se në vitin 2020-2021 krahasuar me vitet 2017, 2018 dhe 2019 ka një rritje të çështjeve të gjykuara. Ngarkesa vijon të mbetet shumë e lartë për numrin e gjyqtarëve në organikën e gjykatës.

Grafiku.5



3. LIKUJDIMI/PËRFUNDIMI I ÇËSHTJEVE.

Numri i çështjeve të mbartura në fund të vitit, për vitin pasardhës, në pesë vitet e fundit:


Tabela.5

Çështje të mbartura në fund të vitit, për vitin pasardhës (penale dhe civile)				
Viti 2017	Viti 2018	Viti 2019	Viti 2020	Viti 2021
303	438	445	899	826

Nga analiza e të dhënave të mësipërme rezulton se në fund të vitit 2021, numri i çështjeve të mbartura është ulur krahasuar me vitin paraardhës. Ndërsa për periudhën 2017-2020 vihet re një

rritje progresive. Rritja e numrit të çështjeve të mbartura në fund të viteve 2020 dhe 2021 lidhet me arsyet me largimin e 3 gjyqtarëve (2 të shkarkuar nga KPK dhe 1 dalë në pension) . Për rrjedhojë kjo është shoqëruar me rritjen e ngarkesës individuale të gjyqtarëve të mbetur.

Grafiku.6




Në tabelën vijuese, pasqyrohen të dhënat e numrit të çështjeve penale dhe civile, mbetur pa përfunduar në fund të vitit 2021:

Tabela.6

Lloji i çështjeve të mbartura	Numri i çështjeve të papërfunduara në fund të vitit 2021
Civile	164
Penale	662

Grafiku.7



Norma e zgjidhjes/likujdimit të çështjeve “*Clearance rate*”, (që është raporti i thjeshtë i dalë nga pjesëtimi ndërmjet çështjeve të zgjidhura me çështjet e reja të regjistruara brenda një periudhe vjetore, i shprehur në përqindje), në vitin 2021 është 92.91 %. Norma e zgjidhjes së çështjeve tregon nëse gjykata ka qënë e aftë të zgjidhë më shumë çështje se sa janë regjistruar për shqyrtim dhe për rrjedhim nëse edhe një pjesë e çështjeve të mbartura nga viti i mëparshëm janë zgjidhur. Norma e likujdimit mbi 100% është tregues pozitiv për likujdimin e çështjeve si Gjykatë. Vlera 92.91 % e *Clearance rate* për vitin 2021 sigurisht që nuk konsiderohet pozitive, por ajo tregon pamjaftueshmërinë e numrit aktual të gjyqtarëve për gjykimin e një numri të lartë çështjesh.

Në fakt, konstatohet që norma e likujdimit të çështjeve civile është më e lartë se norma e likujdimit të çështjeve penale, përkatësisht 109.48 % dhe 81.32%. Megjithëse këto norma mund të konsiderohen të pranueshme, kujdes i veçantë nevojitet në menaxhim më aktiv në qarkullimin e çështjeve penale, sidomos në trajtimin e Penaleve të Veçanta dhe çështjeve administrative penale në fazën e ekzekutimit, pasi në penalet e themelit *Clearance rate* është rreth 57.30. Në qarkullimin e çështjeve civile *Clearance rate* është 109.48% pra janë përfunduar më shumë çështje sesa janë regjistruar të reja.

Gjithsesi, duke patur parasysh edhe ngarkesën e lartë me çështje të regjistruara të reja në vitin 2021, si dhe largimin edhe të dy gjyqtarëve gjatë vitit 2021, por dhe situatën e krijuar në gjykatë nga pandemia, ku pjesa më e madhe e gjyqtarëve kaluan sëmundjen dhe u detyruan të karantinohen, ky tregues i këtij viti konsiderohet pozitiv.

- Për të gjitha çështjet e shqyrtuara në gjykatë në vitin 2021, norma e përfundimit/likujdimit të çështjeve “*Clearance rate*” është **92.91 %**.

$$\text{Clearance rate}_{total} = \frac{2215 \text{ [numri i çështjeve të gjykuara]}}{2384 \text{ [numri i çështjeve të reja për 2021]}} \times 100\% = 92.91 \%$$

- Për çështjet e natyrës penale, norma e përfundimit/likujdimit të çështjeve “*Clearance rate*” është **81.32%**

$$\text{Clearance rate}_{penale} = \frac{1141 \text{ [numri i çështjeve të gjykuara]}}{1403 \text{ [numri i çështjeve të reja për 2021]}} \times 100\% = 81.32\%$$

- Për çështjet e natyrës civile, norma e përfundimit/likujdimit të çështjeve “*Clearance rate*” është **109.48 %**

$$\text{Clearance rate}_{civile} = \frac{1074 \text{ [numri i çështjeve të gjykuara]}}{981 \text{ [numri i çështjeve të reja për 2021]}} \times 100\% = 109.48 \%$$

a. Çështje penale themeli.


Nga 302 çështje të gjykuara të natyrës penale themeli, rezulton se prej tyre janë gjykuar me trup gjykues të përbërë nga një gjyqtar 298 çështje penale, ndërsa 4 çështje penale janë gjykuar me trup gjykues të përbërë me tre gjyqtarë.

Pas muajit Gusht të vitit 2017, pra edhe në këto vite në vazhdim, rezulton një numër i vogël çështjesh të gjykuara me trup gjykues të përbërë me tre gjyqtarë, për shkak të ndryshimit në nenin 13 të K.Pr.Penale, që lidhet me rritjen e maksimumit të dënimit penal nga 7 vjet në 10 vjet, për çështjet që gjykohen me tre gjyqtarë.

Tabela.7

Nr.	Natyra e çështjeve	Numri i çështjeve në vitin 2018	Numri i çështjeve në vitin 2019	Numri i çështjeve në vitin 2020	Numri i çështjeve në vitin 2021
1	Penale themeli	221	329	550	302
2	Kërkesa penale, kërkesa administrative-penale etj.	1009	457	692	876

Grafiku.8




Në lidhje me vendimmarrjen e gjykatës në çështjet e natyrës penale themeli, rezulton se gjatë vitit 2021, janë dënuar në total 269 persona, 4 gra dhe 265 meshkuj, nga të cilët 1 të mitur në konflikt me ligjin (mashkull).

Për 28 persona gjykata ka dhënë vendim pafajësie, për 11 persona gjykata ka vendosur pushimin e çështjes penale


Tabela.8

Vendimarrja në penale themeli	Viti 2021
Të dënuar	269
Të pafajshëm	28
Pushimin e çështjes	11
Totali i personave të gjykuar	308


Grafiku.9



Grafiku.10



Grafiku.11



Gjatë vitit 2021 në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë janë gjykuar 5 të mitur në konflikt me ligjin. Në mbështetje të nenit 282 të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur të miratuar me ligjin nr.37/2017, në zbatim të Udhëzimit nr.79 datë 30.05.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, “Për caktimin e gjyqtarëve, për gjykimin e çështjeve penale me të mitur në konflikt me ligjin ose të mitur viktimë nga vepra penale” janë caktuar gjyqtarët e specializuar për çështjet penale me të mitur, për gjykimin e çështjeve penale me të mitur në konflikt me ligjin ose të mitur viktimë nga vepra penale.

Në tabelën që pason po paraqesim të dhëna statistikore për numrin e personave të gjykuar në bazë të figurës së veprës penale për vitin 2021 :

Tabela.9

Neni	NGA TË GJYKUARIT			
	Të dënuar	Të pafajshëm	Të pushuar	Totali
KRIME				
Neni 76 : Vrasja me dashje	2	0	0	2
Neni 88 : Plagosja e rëndë me dashje	2	0	0	2
Neni 108 : Vepra të turpshme	2	0	0	2
Neni 121-a : Përndjekja	2	1	0	3
Neni 130-a : Dhuna në familje	12	0	0	12


ANALIZA VJETORE E GJYKATËS SË RRETHIT GJYQËSOR GJIROKASTËR PËR VITIN 2021

Neni 134 : Vjedhja	17	0	0	17
Neni 139 : Vjedhja me dhunë	2	0	0	2
Neni 140 : Vjedhja me armë	1	0	0	1
Neni 143 : Mashtrimi	2	0	0	2
Neni 150 : Shkatërrimi i pronës	3	0	0	3
Neni 151 : Shkatërrimi i pronës me zjarr	1	0	0	1
Neni 155 : Shkatërrimi i rrugëve	1	0	0	1
Neni 171 : Kontrabanda me mallra të ndaluara ose të kufizuara	1	0	0	1
Neni 173 : Kontrabanda me mallra të licencuara	1	0	0	1
Neni 179 : Ruajtja apo depozitimi i mallrave kontrabandë	2	0	0	2
Neni 180 : Fshehja e të ardhurave	1	1	0	2
Neni 186 : Falsifikimi i dokumenteve	2	0	1	3
Neni 189 : Falsifikimi i letërnjoftimeve, i pasaportave ose i vizave	2	0	0	2
Neni 190 : Falsifikimi i vulave, i stampave ose i formularëve	2	2	0	4
Neni 199/a : Ndërtimi i paligjshëm	3	0	0	3
Neni 232 : Stërvitja për kryerjen e veprave me qëllime terroriste	1	0	0	1
Neni 236 : Kundërshtimi i punonjësit të policisë së rendit publik	1	0	0	1
Neni 237 : Goditjet për shkak të detyrës	3	1	0	4
Neni 248 : Shpërdorimi i detyrës	1	0	0	1
Neni 278: Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyesë dhe i municionit.	4	0	1	5
Neni 278-a: Trafikimi i armëve dhe i municionit.	0	0	0	0
Neni 279: Prodhimi, mbajtja, blerja apo shitja pa leje e armëve të ftohta.	0	1	0	1
Neni 283: Prodhimi dhe shitja e narkotikëve.	15	2	1	18
Neni 284: Kultivimi i bimëve narkotike	32	0	0	32
Neni 287: Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale	1	0	0	1
Neni 289: Shkelja e rregullave të mbrojtjes në punë	0	1	0	1
Neni 290: Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor	6	0	0	6
Neni 291: Drejtimi i automjeteve në mënyrë të parregullt	32	1	1	34
Neni 293: Pengimi i qarkullimit të mjeteve të transportit	1	1	0	2
Neni 298: Ndhurma për kalim të paligjshëm të kufijve	14	0	0	14
Neni 300: Moskallëzimi i krimit	1	0	0	1

ANALIZA VJETORE E GJYKATËS SË RRETHIT GJYQËSOR GJIROKASTËR PËR VITIN 2021

Neni 302: Përkrahja e autorit të krimit	1	0	0	1
Neni 305-a: Deklaratat e rreme përpara prokurorit	2	0	0	2
Neni 306: Dëshmia e rreme	1	0	0	1
Neni 309: Ekspertimi i rremë	0	1	0	1
Neni 323: Largimi i të burgosurit nga vendi i qëndrimit	3	0	0	3
Total Krime	180	12	4	196
KUNDËRVAJTJE				
84	1	0	0	1
89	5	0	1	6
90	1	0	1	2
112	1	0	0	1
120	1	2	1	4
125	3	0	1	4
130	2	0	0	2
137/1	3	1	0	4
157	1	0	0	1
179/a	3	0	0	3
182	0	1	0	1
197	2	0	0	2
199	5	0	1	6
200	1	0	0	1
236/1	3	0	1	4
242	3	0	0	3
262	1	0	0	1
273	1	0	0	1
275	3	0	0	3
277	1	0	0	1
280	1	0	0	1
290/1	1	0	1	2
297	45	12	0	57
305/a1	1	0	0	1
Total Kundërvajtje	89	16	7	112
TOTALI	269	28	11	308

Grafiku.12



Nisur nga të dhënat e mësipërme rezulton se kriminaliteti në Rrethin Gjyqësor të Gjirokastrës, kryesisht karakterizohet nga veprat penale me rrezikshmëri të ulët. Veprat penale më të përhapura në vitin 2021 janë veprat penale të “Drejtimit të mjetit në mënyrë të parregullt” pa leje drejtimi ose në gjendje të dehur, “Dhuna në familje”, “Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor”, veprat penale të lidhura me lëndët narkotike.

Këtë vit, vërehet një ulje e lehtë e veprës penale “Drejtimi i automjeteve në mënyrë të parregullt”. Gjithsesi, treguesi është ende i lartë. Për rrjedhim ka nevojë për më shumë ndërgjegjësim dhe parandalim të kësaj veprë penale nga institucionet përgjegjëse.


Shqetësuese gjatë vitit 2021, megjithëse me një rënie të lehtë, përbën vepra penale e “Dhunës në familje”, duke e bërë 2021 si vitin e dytë me treguesin më negativ (pas 2020) për sa i përket kësaj veprë penale, në 10 vitet e fundit. Ky është tregues domethënës i problematikës dhe fenomenit të dhunës në familje. Vërehet se viktimat e dhunës në familje në një numër të konsiderueshëm rastesh kërkojnë urdhër mbrojtje, por jo ndjekje penale. Konstatohet se për vitin 2020 nga ana e Prokurorisë janë referuar për dërgim në gjykim 31 procedime në lidhje me neni 130/a të Kodit Penal. Për vitin 2021 janë referuar 22 raste.

Në tabelën 10 pasqyrohen llojet e dënimeve të dhëna nga gjykata:


Tabela.10

Dënimi	Numri i personave të dënuar në vitin 2021
Me gjobë	66
Burgim deri në dy vjet.	166
Burgim nga 2 deri ne 5 vjet.	29
Burgim nga 5 deri ne 10 vjet.	6
Burgim nga 10 deri ne 25 vjet.	0
Burgim nga 25 deri ne 35 vjet	0
Burgim i përjetshëm	0
Aplikimi i nenit 59	6
Aplikimi i nenit 59/a	0
Aplikimi i nenit 63	1

Grafiku.13



Grafiku.14



Rezulton që numri i personave të dënuar gjatë vitit 2020 është 462, ndërsa për vitin 2021 është 269. Gjatë vitit 2021 nuk rezulton të jetë dënuar asnjë person me burgim të përjetshëm. Në vitin 2021 numri i personave të dënuar me gjobë është përgjysmuar krahasuar me një vit më parë. Për të dyja vitet, dënimi më i aplikuar nga gjykata është dënimi me burgim deri në 2 vjet, i cili referuar të dhënave statistikore për figurat e veprave penale, përputhet me rrezikshmërinë e ulët të veprave penale më të përhapura. Por për vitin 2020, krahasuar me 2021 bie në sy aplikimi i gjerë i nenit 59 dhe 63 i K.Penal, si dënime alternative, duke pezulluar dënimin me burgim dhe vënien në provë, i ndjekur nga kryerja e një pune me interes publik pa shpërblim.

Nëse nisemi nga qëllimi themelor që është mbrojtja e interesave publike, do të vërejmë se për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë për vitin 2020 rezulton të jenë dhënë 87 dënime alternative. Nga analiza e të dhënave të vitit 2021 rezulton se numri i çështjeve që janë shqyrtuar me gjykim të shkurtuar, si dhe gjykimi i drejtpërdrejtë janë aplikuar në pak raste, gjithsej. Me ndryshimet me ligjin nr.35/2017 të K.Pr.Penale janë shtuar edhe lloje të tjera të gjykimeve të posaçme si Urdhëri penal dhe Marrëveshja për pranimin e fajësisë. Por, numri i këtyre gjykimeve është i ulët.

b. Kërkesat penale.

Gjatë vitit 2021 janë gjykuar 839 çështje të natyrës kërkesa penale dhe kërkesa penale-administrative, ku përfshihen kërkesat në fazën e hetimeve paraprake, si vleftësim arresti dhe caktim mase sigurimi personal, lejim përgjimi etj, kërkesa në fazën e ekzekutimit të dënimit, si ulje

dënimi, lirim para kohe me kusht nga vuajtja e dënimit, aplikim të dënimeve alternative, kërkesa për marrëdhëniet juridiksionale me jashtë si kërkesa për njohje të vendimeve të gjykatave të huaja, kërkesë për ekstradim etj.

Gjykata në vitin 2020 ka shqyrtuar 692 kërkesa penale, ku përfshihen edhe lejim apo vleftësim të përgjimit, ndërsa për vitin 2021 vihet re një ulje krahasuar me të dhënat e vitit 2020.

Në vitin 2021 janë shqyrtuar 189 kërkesa me objekt vlerësim arresti, caktim mase, 63 raste janë kërkesa për rivlerësim masash sigurimi, 5 raste garanci pasurore, 19 raste përgjime dhe 336 kërkesa të tjera. Në total, konstatohet një ulje me 80 raste krahasuar me vitin 2020.


Rezulton se masat e sigurimit më të aplikuara nga gjykata janë ato “detyrim për paraqitje në policinë gjyqësore” dhe “arrest në burg”. Në disa raste, masat e sigurimit personal të karakterit shtrëngues janë caktuar së bashku me masa të tjera shtrënguese si “Ndalim i daljes jashtë shtetit” dhe masa ndaluese si “Pezullim i ushtrimit të një detyre apo shërbimi publik”.

Tabela.11

Natyra e çështjes	Viti 2018	Viti 2019	Viti 2020	Viti 2021
Kërkesa penale	221	329	550	302

Nga të dhënat për vitin 2019, krahasuar me 2 vitet pasardhës, vërehet një rritje e numrit të këtyre kërkesave.

Grafiku.15



c. Kërkesat penale në seancë paraprake.

Pas ndryshimeve, me ligjin nr.35/2017 në K.Pr.Penale, numri i kërkesave të seancës paraprake si kërkesa penale për dërgimin e çështjes në gjyq dhe kërkesa për pushimin e çështjes penale për


krime, vazhdon të jetë i lartë, por gjithsesi në vlera të qëndrueshme, krahasuar me dy vitet paraardhës.

Në vitin 2021 janë paraqitur gjithsej për shqyrtim 517 kërkesa të seancës paraprake, nga të cilat kanë përfunduar 409, me tregues sipas tabelës së mëposhtme.

Tabela.12

MËNYRA E PËRFUNDIMIT TË KËRKESAVE PENALE					
Pushuar	Kaluar për gjykim	Kthim për plotësim hetimesh (penale)	Vendosur Moskompetenca	Të tjera	Përfunduar
118	229	24	12	26	409

Grafiku.16



d. Çështjet civile:

Gjatë vitit 2021, janë gjykuar gjithsej 1074 çështje civile, nga të cilat 616 civile themeli.

Në lidhje me përbërjen e trupit gjykues, në vitin 2021 janë gjykuar me trup gjykues të përbërë me një gjyqtar 1071 çështje civile dhe me trup gjykues të përbërë nga tre gjyqtarë janë gjykuar vetëm 3 çështje civile.

Nga analiza e të dhënave statistikore konstatohet një numër prej 134 çështje civile të pushuara gjatë vitit 2021. Duke u krahasuar me 192 çështje civile të pushuara në vitin 2020, vihet re një rënie prej 58 çështjesh.

Gjithsesi, numri i çështjeve civile të pushuara mbetet në nivel mesatar dhe lidhet me mosndërgjegjësimin për plotësimin e elementëve të padisë, mosparaqitja e paditësit/kërkuesit pa shkaqe të arsyeshme dhe tërheqja nga gjykimi i padisë/kërkesës. Rastet e padisë që nuk mund të ngrihet janë të pakta.


Në zbatim edhe të vendimit të KLD-së nr.238/1/a, datë 24.12.2008 “Për procedurat e ndarjes me short të çështjeve gjyqësore”, çështjet e pushuara dhe çështjet për të cilat është vendosur “Kthim Akte”, kur janë paraqitur përsëri për shqyrtim në gjykatë, i kanë kaluar automatikisht të njëjtit gjyqtar që i ka pushuar më parë.

Disa nga llojet më të përhapura të çështjeve të natyrës civile të gjykuara gjatë vitit 2021, paraqiten si vijon:


Tabela.13

Lloji i çështjes	Numri i çështjeve në vitin 2019	Numri i çështjeve në vitin 2020	Numri i çështjeve në vitin 2021
Padi pronësie	22	11	139
Pjesëtim sendi	24	31	15
Kundërshtim të veprimeve përmbartimore	55	58	44
Padi për marrëdhënie pune	32	57	56
Të tjera kontraktuale	93	89	53
Vërtetim fakti juridik	134	203	101
Familjare	249	354	192
Lëshim urdhër ekzekutimi	263	374	272
Urdhra të menjëhershëm të mbrojtjes	54	60	77

Grafiku.17



Grafiku.18




Nga analiza e të dhënave të mësipërme rezulton se edhe për vitin 2021 ngarkesa me e lartë është me çështje familjare (192) ,çështje pronësie dhe pas tyre renditen kërkesat për lëshim urdhër ekzekutimi. Çështjet familjare gjatë 2020 janë 354, ku mbizotërojnë paditë për zgjidhje martese (292 të tilla). Paditë për zgjidhje martese kanë pësuar ulje krahasuar me numrin prej 205 çështje të gjykuara në vitin 2020. Kjo lidhet me faktin se vihet re një ulje e numrit të padive për zgjidhjen e martesës.

Përsa i përket urdhrave të menjëhershëm të mbrojtjes, numri i përgjithshëm i tyre ka një rritje këtë vit, me 77 kërkesa, kur në 2020 kishim përkatësisht 60 kërkesa ,ndërsa ne vitin 2019 54 kërkesa . Nga të dhënat e vitit 2019 rezulton se kanë kërkuar lëshimin e urdhërit të menjëhershëm të mbrojtjes 54 shtetas, në vitin 2020 ky numër shkon në 60 persona, në vitin 2021 nga të dhënat e vitit rezulton se kanë kërkuar lëshimin e urdhërit të menjëhershëm të mbrojtjes 77 shtetas . Nga analiza e mësipërme konstatohet një rritje e numrit të kërkesave nga viti në vit . Pothuaj të gjitha kërkesat për urdhër mbrojtje janë përcjellë/paraqitur nga ana e Komisariateve të Policisë në bazë të formularëve të plotësuar nga kërkuesit.

Tabela.14

Lloji i çështjes civile	Total	Pranuar	Pushuar	Refuzuar	Mbartur
Urdhër i menjëhershëm mbrojtje	77	33	25	11	8

Grafiku.19



Nga analiza e të dhënave vërehet se numri i rasteve të refuzimit është më i vogël në raport me numrin e rasteve kur gjykata ka pranuar lëshimin e urdhërit të menjëhershëm të mbrojtjes. Shkaqet e refuzimit të kërkesës për lëshimin e urdhërit të menjëhershëm të mbrojtjes lidhen me mosvërtetimin e ushtrimit të dhunës dhe marrëdhënies familjare sipas përcaktimit në ligj, por konstatohet edhe një numër i lartë i rasteve të pushimit. Shkaqet e pushimit janë mosparaqitja e

viktimës së dhunës në familje në seancë pa shkaqe. Praktika mbizotëruese është ajo e shqyrtimit të kërkesës për urdhër të menjëhershëm të mbrojtjes edhe në rast të mosparaqitjes në seancë apo tërheqjes së viktimës së dhunës në familje kur janë përcjellë/paraqitur nga ana e Komisariateve të Policisë.

e. Kërkesat civile (çështje civile pa palë kundërshtare)

Tabela.15

Lloji kërkesave civile pa palë kundërshtare	Numri i kërkesave në vitin 2019	Numri i kërkesave në vitin 2020	Numri i kërkesave në vitin 2021
Lëshimi i urdhërit të ekzekutimit	263	374	272
Vërtetim fakti i vjetërsisë në punë	134	203	101
Lëshim autorizimi për të miturin	6	11	7


Nga analiza e të dhënave rezulton se ngarkesa më e lartë për vitin 2020 është me kërkesat për lëshimin e urdhërit të ekzekutimit, ku mbizotërojnë kërkesat për tituj ekzekutivë si faturat e energjisë elektrike, fatura të konsumit të ujit dhe kontratat e kredisë bankare, por gjithsesi, numri i këtyre kërkesave, këtë vit, është ulur me 102 raste më pak krahasuar me vitin 2020, dhe gati njësoj krahasuar me vitin 2019.

Nga viti 2020 në vitin 2021 konstatohet një ulje e numrit të kërkesave për vërtetimin e faktit të vjetërsisë në punë nga ana e shtetasve që kërkojnë përfitimin e të drejtës për pension, për shkak të ndryshimeve ligjore në lidhje me Vendimin nr.00-21556 datë 07.05.2021 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.

Grafiku.20



Grafiku.21



4. NGARKESA ME ÇËSHTJE PËR GJYQTAR.

Aktualisht trupa gjyqësore nuk është e plotësuar me numrin 6. Në fillim të vitit 2021, gjykimet bëheshin nga 5 gjyqtarë. Gjatë vitit 2021, pas shkarkimit të 1 gjyqtari nga KPK ,dhe 1 gjyqtar doli ne pension, viti u mbyll me 3 gjyqtarë. Në këto kushte, mbetet nevojë emergjente plotësimi e numrit të gjyqtarëve për shkak të ngarkesës shumë të lartë në punë.

Të dhënat statistikore për ngarkesën e çdo gjyqtari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë gjatë vitin 2021 sipas numrit të çështjeve të gjykuara janë:

Tabela.16

Nr.	Gjyqtar	Numri i çështjeve të përfunduara për vitin 2021	Penale	Kërkesa penale	Civile	Kërkesa civile
1	ARBEN DOSTI	564	247	39	173	105
2	BLERTA ÇIBUKU (MARKU)	634	271	49	184	130
3	SUELA DASHI	662	320	56	181	105
4	MIRELA ILIOPULLO*	298	134	22	88	54
5	PËLLUMB VEHBİ**	163	84	6	48	25

****Këshilli I Lartë Gjyqësor me vendim nr.148 me datë 08/04/2021 ka vendosur deklarin e mbarimit të statusit të magistratit për gjyqtarin Pëllumb Vehbi.**

Dosjet e këtij gjyqtari janë rishortuar me datë 15/04/2021 dhe janë përcjellë pranë 4 gjyqtarëve për veprim .


*** Me vendim të KPK datë 13.07.2021, Gjyqtare M.Iliopullo është shkarkuar nga detyra.**

Dosjet e kësaj gjyqtare janë rishortuar me datë 28/07/2021 dhe janë përcjellë pranë 3 gjyqtarëve për veprim .

Në këtë ngarkesë është llogaritur edhe prania si anëtar, në gjyqet që zhvillohen me tre anëtarë.

Në vijim është paraqitja grafike e shpërndarjes së numrit të çështjeve të përfunduara gjatë vitit 2021:

Grafiku.22



Nga analiza e të dhënave evidentohet fakti se ngarkesa e gjyqtarëve me çështje plotëson parametrat e vendosura në vendimin e KLD-së për kriteret matëse të vlerësimit të veprimtarisë së gjyqtarëve.

Bazuar në një llogaritje mesatare të ngarkesës për gjyqtar, duke pjesëtuar numrin total të çështjeve të regjistruara në vitin 2021 me numrin e gjyqtarëve të gjykatës, rezulton një numër mesatar prej 476 të çështjeve të reja për gjyqtar. Ky tregues nxjerr në pah ngarkesën e lartë në punë për gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë.

Shpërndarja e ngarkesës ndërmjet gjyqtarëve (me përjashtim të Zv/Kryetarit të gjykatës dhe gjyqtarëve të larguar) në vitin 2021 është pothuaj e barabartë në numër çështjesh (duke mos patur parasysh kompleksitetin e çështjeve).

Gjatë vitit 2021 janë regjistruar në total 2384 çështje të reja dhe kanë përfunduar 2215 çështje.

Raporti mbi numrin i çështjeve për çdo gjyqtar (Case for Judge), llogaritur duke pjesëtuar numrin total të çështjeve të regjistruara në vitin 2021 me numrin e gjyqtarëve të gjykatës:

$$\frac{2384 \text{ [totali i numrit të çështjeve të regjistruara]}}{5 \text{ [numri i anëtarëve të gjykatës në vitin 2021]}} = 476 \text{ Numri i çështjeve të reja për gjyqtar}$$

Ndërsa numri i çështjeve të gjykuara për çdo gjyqtar rezulton si më poshtë:

$$\frac{2215 \text{ [totali i numrit të çështjeve të gjykuara]}}{5 \text{ [numri i anëtarëve të gjykatës në vitin 2021]}} = 443 \text{ Numri i çështjeve për gjyqtar}$$

Ngarkesa e lartë e gjyqtarëve ka ndikuar në afatin e arsytimit të vendimeve gjyqësore, por gjithsesi nuk është tejkaluar afati 30 ditë i përcaktuar sipas raportimit pranë KLGJ si dhe përgjithësisht janë respektuar afatet ligjore të arsytimit të vendimeve.

a. Delegimet e gjyqtarëve:

Gjatë vitit 2021, gjyqtarët e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë kanë qenë të deleguar për të gjykuar çështje në gjykata të tjera (Përmet, Sarandë). Ndërkohë për nevojat e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë kanë qenë të deleguar për të gjykuar në këtë gjykatë, 4 gjyqtarë nga Gjykatat e tjera, për 4 çështje civile, për 8 çështje penale. Megjithatë ndryshimet në K.Pr.Civile dhe K.Pr.Penale që kanë sjelle rënien e numrit të çështjeve që gjykohen me trup gjykues të përbërë nga tre gjyqtarë, delegimet mbeten domosdoshmëri për shkak të konsumimit të trupave gjykues si pasojë e vendimarrjes së mëparshme të tyre në çështje të lidhura ose të konfliktit të interesit që mund të kenë patur gjyqtarët e gjykatës, si dhe numrit të vogël të gjyqtarëve të mbetur aktualisht në gjykatë.

Tabela. 17

Gjyqtar	Delegime	
	Penale	Civile
Blerta ÇIBUKU(MARKU)	2	0
Suela DASHI	2	1
Mirela ILIOPULLO	1	1
Pëllumb VEHBİ	1	1

5. SHPEJTËSIA NË GJYKIM SIPAS KATEGORISË SË ÇËSHTJEVE.

➤ Raporti i shpejtësisë së gjykimit të çështjeve në total, penale dhe civile

Nga totali i çështjeve të gjykuara rezulton se 2160 çështje janë përfunduar së gjykuari brenda afatit 6 muaj dhe 55 çështje kanë përfunduar së gjykuari në harkun kohor 7-12 muaj. Nga verifikimi nuk rezultojnë çështje me afat gjykimi mbi 2 vjet.


Tabela.18

Kategoria e Çështjeve	ÇËSHTJE TË PËRFUNDUARA GJATË VITIT 2021			
	1-6 Muaj		7-12 Muaj	
	Nr	%	Nr	%
Civile të përgjithshme me palë kundërshtare	380	97.4	10	2.6
Familjare me palë kundërshtare	185	100	0	
Marrëdhënie pune	39	95.1	2	4.9
Civile të përgjithshme pa palë kundërshtare	428	95.1	22	4.9
Familjare pa palë kundërshtare	7	87.5	1	12.5
TOTALI CIVILE	1039	96.7	35	3.3
Penale themeli (krime)	190	97.9	4	2.1
Penale themeli (kundërvajtje)	96	88.9	12	11.1
Kërkesa administrative penale	835	99.5	4	0.5
TOTALI PENALE	1121	98.2	20	1.8
TOTALI I ÇËSHTJEVE	2160	97.5	55	2.5

Më poshtë po paraqesim grafikisht edhe raportet e shpejtësisë të gjyimit për çështjet.


Raporti i shpejtësisë së gjyimit të çështjeve penale:

Grafiku.23



Raporti i shpejtësisë së gjykimit të çështjeve civile:

Grafiku.24



➤ Analizë mbi përmbushjen e standarteve kohore ndërkombëtare

Gjykata ka përcaktuar si objektiv të brendshëm, arritjen e respektimit të afateve të gjykimit të çështjeve sipas kategorisë më cilësore “A” të CEPEJ (Time Frames “A”). Nga statistikat e mësipërme rezulton se janë përmbushur plotësisht afatet e gjykimit të çështjeve sipas kategorisë më cilësore “A” të CEPEJ (Time Frames “A”).

Konkretisht, për vitin 2021, 98.2 % e çështjeve penale nuk kanë zgjatur më shumë se 6 muaj, ndërkohë që për çështjet në total kjo përqindje shkon në 97.5% (krahasuar me standartin 90-95%), kurse vetëm 2.5 % janë mbyllur brenda vitit të parë të gjykimit. Nëse konsiderojmë vetëm çështjet penale themeli, vetëm 3.3% e tyre kanë zgjatur 7- 12 muaj, ndërsa 96.7% (krahasuar me standartin 90-95%) janë zgjidhur brenda 6-mujorit të gjykimit.

Gjithashtu përsa i përket çështjeve penale në gjykim (të papërfunduara), për vitin 2021 nuk konstatohet të ketë çështje, të cilat e kanë kaluar afatin 1 vit. Në rastet e kohëzgjatjes së gjykimit mbi një vit, kryesisht shkak është pezullimi i gjykimit për të pandehurin në mungesë për kryerjen e kërkimeve të tjera me afat një vit dhe njoftimi i viktimës apo të pandehurit me letërporosi.

Nga të dhënat statistikore për çështjet civile rezulton se vetëm 3.3 % e çështjeve të gjykuara është në kohëzgjatje gjykimi 7-12 muaj, ndërsa 96.7 % (krahasuar me standartin 90-95%) e çështjeve

civile janë gjykuar brenda 6 muajve.

Gjykata ka përcaktuar si objektiv të brendshëm të saj, dhënien e përparësisë në gjykim të çështjeve tejet komplekse, me qëllim moskalimin e afatit 2 vjeçar të gjykimit, në respektim të jurisprudencës së Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut.

Nga analiza e të dhënave për çështjet civile për të cilat periudha e gjykimi zgjat 1-2 vjet rezulton se numri është shumë i vogël, vetëm 24 të tilla (apo 14.6% të tyre).

Shkaqet e tejkalimit të afatit 1-2 vjet janë kryesisht shkaqe ligjore që përjashtojnë përgjegjësinë për tejkalimin e afatit si:

- pezullimi i gjykimit deri në zgjidhjen e një çështje tjetër gjyqësore, apo rastet e tjera të pezullimit të parashikuara në ligj;
- në gjykimet e pjesëtimit të pasurisë së paluajtshme mosvazhdimi i gjykimit në fazën e dytë të pjesëtimit deri në marrjen formë të prerë të vendimit të gjykatës për fazën e parë të pjesëtimit;
- shkaqe objektive për zëvendësimin e gjyqtarëve të çështjes si heqje dorë , procesi i vetingut, kërkesa për përjashtim etj., për rrjedhim rifillimi i gjykimit, njëkohësisht me njoftimet me shpallje për palët, si dhe ekspertime.

Koha e nevojshme për përfundimin/likuidimin e çështjeve (*case disposition time*) është treguesi që krahason numrin total të çështjeve të pazgjidhura, në fund të periudhës së caktuar, me numrin e çështjeve të zgjidhura, brenda të njëjtës periudhë kohore, raport ky i konvertuar në numër ditësh. Treguesi mat se sa shpejt sistemi gjyqësor i gjykatës punon mbi çështjet e marra që nënkupton kohën që duhet për përfundimin e një lloji çështjesh të caktuara në gjykatë, në dritën e ritmit të punës në atë gjykatë.

Koha e nevojshme për përfundimin/likuidimin e çështjeve (*case disposition time*) për çështjet e natyrës penale është 211.77 ditë.

$$DT_{\text{Penale } 2021} = \frac{\text{Numri i çështjeve në pritje për gjykim në 31.12.2021}}{\text{Numri i çështjeve të zgjidhura në 2021}} \times 365 = \frac{662}{1141} \times 365 = 211.77$$

Koha e nevojshme për përfundimin/likuidimin e çështjeve (*case disposition time*) për çështjet e natyrës civile është 55.7 ditë.

$$DT_{\text{Civile } 2021} = \frac{\text{Numri i çështjeve në pritje për gjykim në 31.12.2021}}{\text{Numri i çështjeve të zgjidhura në 2021}} \times 365 = \frac{164}{1074} \times 365 = 55.7$$

Koha e nevojshme për përfundimin/likuidimin e çështjeve (*case disposition time*) për të gjitha çështjet në total është 136.11 ditë.

$$DT_{2021} = \frac{\text{Numri i çështjeve në pritje për gjykim në 31.12.2021}}{\text{Numri i çështjeve të zgjidhura në 2021}} \times 365 = \frac{826}{2215} \times 365 = 136.11$$


Për të krahasuar të dhënat dhe për të kuptuar më mirë ecurinë, po bëjmë tabelën dhe grafikun e tendencës për dyvjeçarin e fundit 2020-2021.

Për çështjet penale :

Tabela.19

Koha e nevojshme për përfundimin/likujdimin çështjeve penale (ditë)	
Viti 2020	Viti 2021
53.64	211.77

Grafiku.25




Për çështjet civile :

Tabela.20

Koha e nevojshme për përfundimin/likujdimin çështjeve civile (ditë)	
Viti 2020	Viti 2021
187.77	55.7

Grafiku.26



Të dhënat e mësipërme tregojnë mesatarizimin e kohëzgjatjes në ditë të gjyqimeve për kategoritë e çështjeve penale dhe civile për vitet 2020, 2021.


Nga krahasimi me vitin paraardhës, në të cilin koha e nevojshme për përfundimin/likujdimin e çështjeve penale ishte përkatësisht 53.64 ditë, rezulton një rritje për kohëzgjatjen mesatare të gjykimit, për shkak se nga ana e Prokurorisë me mbylljen e vitit kalendarik ndodh që depoziton në Gjykatë një numër i lartë çështjesh për gjykim, të cilat regjistrohen në datën e dorëzuar, duke rritur ngarkesën në mënyrë artificiale. Ndërsa për çështjet e natyrës civile themeli vërehet një përgjysmim në kohëzgjatjen mesatare të gjykimit krahasuar me vitin paraardhës.

Ndërsa për totalin e çështjeve, në krahasim me vitin paraardhës, rezulton se koha e nevojshme për likujdimin e të gjitha çështjeve, gjatë vitit 2021, për shkak se një numër i lartë çështjesh është përballuar nga vetëm 3 gjyqtar.

Tabela.21

Koha e nevojshme për përfundimin/likujdimin çështjeve në total (ditë)	
Viti 2020	Viti 2021
108.02	136.11

Grafiku.27




- Të dhënat e sistemit PAKS+ për numrin total të seancave gjyqësore të zhvilluara për vitin 2020 dhe 2021 në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë paraqiten si mëposhtë :

Tabela.22

Kategoria e çështjeve të gjykuara	Numri total i seancave gjyqësore	
	2020	2021
Çështje Civile	2996	3309
Çështje Penale	2560	3863

Grafiku.28




Përsa i përket të dhënave të PAKS për kohëzgjatjen e gjyimeve në ditë dhe në numër seancash për vitet 2020, 2021 pasqyrohen në tabelën 23 dhe paraqiten grafikisht si mëposhtë:


Tabela.23

Kategoria e çështjeve të gjykuara	Mesatarja e numrit të seancave nga depozitimi në vendim për çështje		Kohëzgjatja Mesatare në ditë nga depozitimi në vendim për çështje	
	2020	2021	2020	2021
Çështje Civile	3	3	188	56
Çështje Penale	2	3	54	212

Grafiku.29



Grafiku.30



Sipas të dhënave të sistemit, mesatarja e numrit të seancave prej 3 për çështje civile është pozitive pasi tregon qëndrueshmëri me treguesin 3 të vitit të 2020. Për çështjet penale kemi një rritje të treguesit mesatar të numrit të seancave nga 2 në 3 për vitin 2021, por shkaqet kryesore që sjellin rritjen e numrit të seancave jo efektive, por edhe kohëzgjatjes së gjyqimit, si dhe në vitet e mëparshme, vazhdojnë të jenë problematikat me njoftimet nëpërmjet shërbimit postar, por edhe nëpërmjet shërbimeve të policisë gjyqësore në çështjet penale, veçanërisht kur personi që thirret ndodhet jashtë territorit të Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë. Problemet e njoftimit nëpërmjet shërbimit postar, vijnë kryesisht për shkak se punonjësit që ndryshohen shpesh nuk janë të specializuar dhe veprojnë në kundërshtim me ligjin, për sa i përket plotësimit të të gjitha rubrikave në aktet e njoftimit, tregimit të lidhjes ndërmjet personit që merr përsipër njoftimin dhe personit të thirrur, etj., duke sjellë si pasojë shpalljen të pavlefshëm të njoftimit dhe shtyrjen e seancës për përsëritjen e tij (njoftimit). Ndërsa problemi i njoftimeve nëpërmjet shërbimeve të policisë gjyqësore lidhet kryesisht me mos kthimin në kohë të konfirmimit për kryerjen e njoftimit për datën dhe orën e seancës.

Për sa i përket mesatares së numrit të ditëve për çështje, për shkaqet e sipërcituara si dhe fluksi i çështjeve penale është në rritje krahasuar me numrin e çështjeve civile, është një vlerë më e lartë se e vitit të kaluar, por e pritshme duke patur parasysh ngarkesën e çdo gjyqtari. Nga ana tjetër, fakti që çështjet zgjidhen me pak seanca, tregon efikasitetin e gjykimeve penale dhe civile gjatë kësaj periudhe dyvjeçare.

Për shkak të mospërshtatjes së sistemit elektronik ICMIS me ndryshimet në K.Pr.Penale dhe K.Pr.Civile, por edhe për shkak të specifikës së mënyrës së shqyrtimit dhe mungesës së kompleksitetit, në të dhënat e mësipërme nuk përfshihen një pjesë e çështjeve të shqyrtuara në dhomë këshillimi apo çështje të kategorive të tjera pa palë kundërshtare (kërkesa), por që shpresojmë të janë përmirësuar pas vendosjes së versionit të ri në fillim të vitit 2022.

Një pengesë të konsiderueshme në shpejtësinë e gjyqimit edhe në vitin 2021 përbën sistemi i shërbimit postar të njoftimeve, mungesa e një sistemi të saktë adresash, mungesa e njohurive procedurale të punonjësve të postës që kryejnë njoftimet për llogari të Gjykatës. Faktorët e jashtëm që kanë ndikuar në shpejtësinë në gjykim janë mosparaqitja e palëve në gjykim, paraqitja e kërkesave për shtyrje të seancës, nisur nga pjesëmarrja në gjykim tjetër etj. Në disa raste palët ndërgjyqëse hasin vështirësi për të siguruar dhe paraqitur provat e caktuara të cilat ndodhen pranë institucioneve shtetërore, dhe në disa raste vetë këto institucione përmbushin me vonesë urdhërat e gjykatës. Ndër faktorët e tjerë të brendshëm që ndikojnë në shpejtësinë e gjyqimit mbeten, sikurse në vitin e kaluar, ngarkesa e lartë në punë për secilin gjyqtar, referuar numrit mesatar të çështjeve për gjyqtar dhe organikës së gjykatës. Këto problematika kanë sjellë si domosdoshmëri një rol më aktiv të gjyqtarit për administrimin e procesit gjyqësor. Shkaqet e shtyrjes së seancave dhe zhvillimit të seancave joproductive janë diskutuar rregullisht në të gjitha mbledhjet periodike me gjyqtarët me qëllim dhe duke sjellë në vijim marrjen e masave për reduktimin e tyre.


6. HEQJET DORË NGA GJYKIMI I ÇËSHTJEVE

Kërkesat për heqje dorë në vitin 2021 janë si në Tabelën 23 :

Tabela.23

Kërkesat për heqje dorë	Viti 2021
Pranim	39
Mospranim	10
Totali	49

Grafiku. 31



Shkaqet kryesore të heqjes dorë nga gjykimi i çështjeve edhe në vitin 2021 lidhen me pjesëmarrjen e gjyqtarëve në procese të tjera gjyqësore të lidhura apo vendimarrje të mëparshme ku janë shprehur me vlerësime nga të cilat cënohet paanësia, kjo edhe për shkak të parashikimit në ligj të mos shqyrtimit të një çështje nga gjyqtari që më parë ka gjykuar një çështje tjetër të caktuar. Pjesa tjetër e rasteve të heqjes dorë nga gjykimi lidhet me vlerësimin e ekzistencës së arsyeve të tjera serioze të njëanshmërisë.

7. PËRJASHTIMET E GJYQTARËVE NGA GJYKIMI I ÇËSHTJEVE (Me kërkesë të palëve)

Gjatë vitit 2021 janë pranuar 10 kërkesa për përjashtim gjyqtari nga gjykimi i çështjeve. Nga analiza e rasteve të shqyrtimit të kërkesave për përjashtimin e gjyqtarëve, vërehet se, shkaku kryesor i pranimit të kërkesës për përjashtim është garantimi edhe në dukje i paanshmërisë së gjyqtarit. Ndërsa shkaqet kryesore të rrëzimit të kërkesës për përjashtim janë: paraqitja nga pala kërkuese si shkak përjashtimi vendimarrja e ndërmjetme e gjyqtarit, mosparaqitja e arsyeve të njëanshmërisë nga ato të parashikuara në ligj, dhe mos depozitimi i akteve për të provuar ekzistencën e arsyeve të njëanshmërisë.

Krahasuar me të dhënat e viteve të mëparshme rezulton se ka një qëndrueshmëri të numrit të kërkesave për përjashtim gjyqtari në çështjet penale dhe rritje në çështjet civile.

II. MENAXHIMI I LËVIZJES TË ÇËSHTJEVE GJYQËSORE

1. Mbikqyrja e progresit të çështjeve.

- Implementimi i nismës “Drejtësi pa vonesa” organizuar nga Prezenca e OSBE në Shqipëri në bashkëpunim me USAID, dhe me mbështetjen e plotë të Ministrisë së Drejtësisë dhe Këshillit të Lartë të Drejtësisë ka vazhduar edhe në vitin 2021.
- Në vazhdimësi gjatë vitit 2021 ka patur bashkëpunim dhe mbështetje nga drejtuesi i Prokurorisë, Dhoma Vendore e Avokatisë, për implementimin e masave që lidheshin me reduktimin e kërkesave për shtyrje, konkretizimin dhe bazueshmërinë e tyre në prova, si dhe një planifikim më të mirë të gjyqimit, kryerja e veprimeve procedurale brenda një afati të caktuar etj.
- Edhe me institucionet vendore si Drejtoria e Policisë Gjirokastrë, IEVP Tepelenë, IEVP Sarandë, Zyra Postare Gjirokastrë, ka vazhduar bashkëpunimi për masat e ndërmarra në kuadër të planit të veprimit siç janë: paraqitja e dokumentave të kërkuara përpara seancës, komunikimi i shpejtë me gjykatën edhe në rrugë elektronike, përmirësimi i mënyrës së kryerjes së njoftimeve, aplikimi i mënyrave alternative të njoftimit dhe komunikimit si p.sh me rrugë elektronike nëpërmjet komunikimit me adresën zyrtare të emailit rrethigjirokaster@gjykata.gov.al.
- Gjykata ka aplikuar komunikimin elektronik me e-mail edhe me avokatët apo palë si dhe pjesëmarrës në proces si ekspertët, psikologët etj. si dhe ka përmirësuar përmbajtjen e njoftimeve me qëllim njoftimin në të njëjtën kohë të palëve edhe me të drejtat dhe detyrimet e tyre, si për t’u mbrojtur me avokat para se të fillojë procesi gjyqësor, për të paraqitur prova etj. Po ashtu është kërkuar bashkëpunimi i të gjitha institucioneve vendore për komunikimin në rrugë zyrtare elektronike në një afat sa më të shpejtë nëpërmjet adresës elektronike zyrtare dhe bashkëpunimi me njësitë vendore dhe Bashkitë lidhur me përmirësimin dhe konfirmimin në kohë të njoftimit me shpallje.

III. MENAXHIMI ADMINISTRATIV I GJYKATËS:

1. Organika dhe burimet njerëzore.

- Viti 2021 filloi me një organikë të gjykatës prej 5 gjyqtarë dhe 16 punonjës të administratës gjyqësore, nga të cilët 1 kancelar, 1 kryesekretare, 6 sekretare gjyqësore, 1 specialist IT, 1 arkiviste, 1 K/D/Buxhetit, 1 magaziniere, 1 punonjës sigurie, 1 nënpunës gjyqësor, 1 sanitare, 1 shofer/mirëmbajtës. Gjatë vitit 2021 (në muaji Mars) në organikën e gjykatës është shtuar organika e administratës me 1 specialisti Marrëdhënieve me Publikun dhe Median.

2. Teknologjia e informacionit.

- Sistemi elektronik i menaxhimit të çështjeve gjyqësore ICMIS

Gjykata ka në funksion sistemin elektronik të menaxhimit të çështjeve gjyqësore, ICMIS, që prej vitit 2014, i cili përdoret për regjistrimin e çështjeve gjyqësore, hedhjen e çështjeve në çdo rast në short elektronik, mbajtjen e procesverbaleve të seancave gjyqësore, hedhjen e vendimeve dhe publikimin e vendimeve të anonimizuar në portal. Pjesa e anonimizimit të vendimeve të publikuara në portal, pas instalimit të versionit të përditësuar të ICMIS në Janar të vitit 2021, nuk kryet më manualisht prej sekretareve gjyqësore pasi realizohet automatikisht nga vetë sistemi.

Sistemi elektronik i menaxhimit të çështjeve ICMIS mundëson përveç të tjerash ndarjen e çështjeve ndërmjet gjyqtarëve, me short elektronik. Kërkesat e vendimit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë “Për procedurat e ndarjes së çështjeve me short” janë respektuar në mënyrë rigorozë në lidhje me ndarjen e çështjeve me short si dhe është rritur transparencja e këtij procesi, duke u publikuar paraprakisht koha e realizimit të shortit, duke u garantuar pjesëmarrja e publikut si dhe nëpërmjet publikimit të listës së shortit. Nëpërmjet përcaktimit të vendit të zhvillimit të shortit dhe rishortimit, në hollin e Gjykatës, të pajisur me monitor, është rritur aksesin nga pjesëmarrës të tjerë të interesuar si palët, avokatët mbrojtës, media. Shorti i ditës, publikohet brenda 24-orëve në faqen web të gjykatës.

Nga të dhënat statistikore rezulton se çështjet janë shpërndarë në mënyrë përafërsisht të barabartë për të gjithë gjyqtarët. Diferencat justifikohen duke patur parasysh numrin e çështjeve të regjistruara gjatë gatishmërisë së secilit gjyqtar, që mund të ketë qenë jo i barabartë. Për masat e sigurimit dhe kërkesat gjatë hetimeve paraprake, nga Kryetari e Gjykatës në zbatim të kompetencave ligjore është bërë sistematikisht planifikimi i gatishmërisë të gjyqtarëve sipas grafikut për shqyrtimin e çështjeve të natyrës urgjente, si rregull për një kohë një javore sipas rendit alfabetik duke marrë për bazë mbiemrin e gjyqtarit.

Përsa i përket problematikave teknike të konstatuara gjatë punës si në sistemin ICMIS ashtu dhe në portalin www.gjykata.gov.al, është raportuar në platformën e suportit të kompanisë Kreatx dhe zgjidhja ka ardhur brenda afateve të kërkuara.

➤ Sistemi i regjistrimit audio të seancave gjyqësore RDA

Në kuadër të rritjes së parametrave shpejtësi, përgjegjësi dhe transparencë, në këtë gjykatë ka filluar që prej datës 01.05.2014 të aplikohet sistemi audio rekorder i mbajtjes së seancave gjyqësore për të gjithë gjykimet, me përjashtim të seancave të zhvilluara në dhomë këshillimi për shkak të parashikimeve ligjore (përjashtim gjyqtari, caktim mase sigurimi, lejim ose vleftësim përgjimi) sistem i cili ka funksionuar normalisht gjatë vitit 2021.


Për vitin 2021, janë zhvilluar gjithsej 6283 seanca gjyqësore nga të cilat 6199 janë zhvilluar me regjistrim audio, ndërsa 84 seanca janë zhvilluar në dhomë këshillimi pa sistem audio për shkak të parashikimeve ligjore. Pra, regjistrimi audio i seancave gjyqësore për vitin 2021 është 98.66% e seancave të zhvilluara, çka pasqyron qëndrueshmërinë e përdorimit të teknologjisë audio nga ana e gjykatës.

Raporti për përdorimin e sistemit të regjistrimit audio nga çdo gjyqtar në vitin 2021 i gjeneruar nga PAKS+ paraqitet në tabelën 24 :

Tabela.24

Nr.	Gjyqtari	Seanca të regjistruara audio (SA)	Seanca të paregjistruara (SP)	Gjithsej (TOT)	Në % (SA/TOT *100)
1.	ARBEN DOSTI	1560	11	1571	99.3 %
2.	BLERTA ÇIBUKU(MARKU)	1679	30	1709	98.2 %
3.	SUELA DASHI	1963	42	2005	97.9 %
4.	MIRELA ILIOPULLO	660	0	660	100 %
5.	PËLLUMB VEHBI	278	0	278	100 %
6.	GJERGJI BAÇI	32	1	33	97 %
7.	MARJOLA BELULI	15	0	15	100 %
8.	YRFET SHKRELI	12	0	12	100 %
	TOTALI	6199	84	6283	98.7 %

Grafiku.32



Në vitin 2021, të gjithë palët pjesëmarrëse në një seancë gjyqësore, janë pajisur me CD e regjistrimeve audio, sa herë që kanë bërë kërkesë për të patur një të tillë. Në portalin e gjykatës është vendosur edhe suporti i duhur për përdoruesit e programit FTR, për të dëgjuar regjistrimet audio.

Përdoruesit apo punonjësit janë udhëzuar për përdorimin e sistemit audio dhe kanë realizuar me sukses edhe transkriptimet e procesverbaleve të seancave edhe në rastet kur ai është kërkuar fjalë për fjalë, si dhe është zbatuar udhëzimi për procedurat e dhënies së kopjeve të regjistrimeve audio për përdorim nga publiku.

Zbatimi i këtij sistemi ka treguar se ka rritur ndjeshëm transparencën e gjykimit dhe ka ndikuar ndjeshëm në respektimin e rregullave të etikës dhe solemnitetit në gjykim si për gjyqtarët dhe për palët e avokatët.

Çdo lloj problematike teknike e evidentuar gjatë punës në sistemin audio është raportuar dhe zgjidhur brenda afateve të kërkuara nga kompania e suportit Forsitek shpk.

- Po kështu, në bashkëpunim me projektin Just (USAID), duke filluar nga viti 2011, në Gjykatë është implementuar kalendari elektronik i planifikimit të seancave gjyqësore PAKS+, çka eviton përplasjet në përdorimin e sallave të gjykimit. Raportet e gjeneruara nga sistemi PAKS, qoftë ato për përdorimin e sallave të gjyqit qoftë raportet për përdorimin e audios, nuk pasqyrojnë vetëm çështjet me karakter sekret, si kërkesa për lejim përgjimi, kontrolli, caktim mase sigurimi në mungesë, etj., të cilat nuk regjistrohen në sistemin elektronik, por vetëm në regjistrat manual. Ky kalendar ka funksionuar normalisht dhe gjatë vitit 2021.

3. Kryesekretaria dhe ofrimi i shërbimeve nga administrata gjyqësore.

- Kjo zyrë gjatë gjithë vitit, ka funksionuar me dy nëpunës, kryesekretaren dhe një sekretare gjyqësore, si dhe është mbështetur edhe nga Kancelari. Kancelari veç detyrave të tij në organizmin dhe drejtimin e administratës gjyqësore, ka përpiluar edhe raportet statistikore periodike dhe vjetore sipas modeleve të miratuara nga Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe ndjekjen dhe kthimin e përgjigjes për çdo informacion të kërkuar.
- Detyrat midis kryesekretares dhe sekretares gjyqësore kanë qenë të normuara me vendim të këshillit të gjykatës, kështu sekretaria gjyqësore është ngarkuar dhe ka kryer, pranimin e padive dhe të gjitha kërkesave të tjera që janë paraqitur për proceset gjyqësore, regjistrimin në regjistrat manual dhe sistemin elektronik, shpërndarjen e dosjeve gjyqësore pas procesit të shortit të gjyqtarët dhe numërtimin e çështjeve.
- Kryesekretaria veç organizimit të zyrës ka trajtuar dosjet që nga dorëzimi i dosjeve në sekretari pas përfundimit deri në arkivimin e tyre, si kontrolli i dosjes fizike në momentin e dorëzimit, njoftimet pranimi i ankimeve, dhënien formë të prerë vendimeve, përcjelljen e dosjeve në gjykatat më të larta, përpunimin e tyre pas kthimit, përgatitja dhe përcjellja e buletineve dhe vendimeve institucioneve përkatëse sipas urdhërimeve të gjykatës apo përcaktimeve ligjore dhe përcjella në fund e dosjeve në arkivin e gjykatës.
- Gjatë këtij viti është përmirësuar puna në aspektin e menaxhimit të çështjeve gjyqësore, në lidhje me këto element:
 - për pranimin e kërkesëpadive apo kërkesave të ndryshme,
 - marrjen e identitetit dhe adresave të sakta të palëve,

- marrjen e miratimit për njoftimin elektronik,
 - kopjeve të padive me aktet shoqëruese sa janë palët,
 - për parapagimin e shpenzimeve gjyqësore etj
- Gjatë vitit 2021 janë depozituar gjithsej 404 ankime mbi bazën e të cilave janë përpunuar, përcjellë dosjet në gjykatat më të larta, si dhe janë kryer veprimet përkatëse pas kthimit të çështjeve nga shqyrtimi në gjykatat më të larta. Në përgjithësi dosjet janë përpunuar dhe përcjellë në kohë dhe nuk ka pasur ankesa nga palët. Përcjellja e dosjeve që kanë rekurs direkt nga Gjykata e Apelit ka sjellë një lehtësim të punës në sekretarinë gjyqësore.
- Rëndësi të veçantë i është kushtuar ofrimit të një shërbimi sa më të shpejtë dhe korrekt ndaj publikut. Numri i kërkesave për marrje të kopje të dokumenteve arkivore apo informacioni arkivor të refuzuara, gjatë vitit 2021 ka qënë i papërfillshëm.
- Gjatë 2021 ka patur një numër të konsiderueshëm kërkesash për shërbim nga arkiva. Gjatë dy viteve të fundit, janë transferuar pranë Arkivit Shtetëror të Sistemit Gjyqësor Lundër, Tiranë një numër prej **11 000** dosjesh të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë. Problematikë vijon të mbetet mungesa e hapësirave të nevojshme për sistemimin dhe inventarizimin e dosjeve arkivore në ambientet e arkivës. Për këtë qëllim, janë përdorur edhe ambiente të tjera në gjykatë, por është i nevojshëm shtimi i ambienteve dhe i rafteve metalikë.

4. Aksesi, transparenca, marrëdhëniet me publikun dhe median.

- Në përputhje me nenin 7 të ligjit nr.119/2014 “Për të Drejtën e Informimit” është përgatitur, programi i transparencës për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë. Nëpërmjet këtij programi përcaktohet korniza ligjore e veprimtarisë së autoritetit në kuadër të ligjit nr.119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”. Ky program vlerësohet si një mënyrë konkrete përmes së cilës Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë ndërton dhe rrit transparencën në punën e saj institucionale. Informacioni i bërë publik në këtë program, synon të bëjë transparencën e veprimtarisë së punës së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, nëpërmjet pasqyrit të tij në faqen zyrtare të gjykatës Gjirokastrë, pranë portalit www.gjykata.gov.al . Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë ka marrë të gjitha masat për respektimin maksimal të të gjitha detyrimeve të rrjedhura nga ky ligj, duke publikuar në faqen e saj elektronike zyrtare informacionin dhe dokumentacionin e disponuar prej saj, të parashikuar nga ligji, për publikim kryesisht nga autoriteti publik.
- Rezulton se është kryer një punë e mirë për informimin dhe sensibilizimin e avokatëve, palëve ndërgjyqëse dhe qytetarëve për marrjen e informacionit mbi shortin dhe planifikimet e seancave gjyqësore nëpërmjet faqes elektronike zyrtare të gjykatës në internet.
- Në faqen zyrtare të gjykatës janë publikuar gjatë vitit 2021, edhe video informuese për plotësimin e Formularit Elektronik të Aplikimit, orientimit në gjykatë, si të merret informacion mbi shortin dhe për kalendarin e seancave.
- Me qëllim rritjen e aksesit në drejtësi, është rritur numri i formularëve standart për kërkesa të ndryshme drejtuar gjykatës, Model Deklaratë Mbrojtje në procesin civil dhe akte të tjera të cilat ndihmojnë në veçanti palët e vetpërfaqësuar. Gjithashtu është arritur asistencë e personave me

aftësi të kufizuar. Gjykata ka siguruar akses fizik nëpërmjet rampave të personave me aftësi të kufizuar në lëvizje, në hyrjen e gjykatës.

- Këtë vit u siguria pasja i videokonferences për sigurimin e zhvillimit të seancave pa praninë fizike të personave në kushtet e pandemisë.
- Në prill të vitit 2020, me ndihmën e USAID, në ambjentet e hollit të gjykatës, është vendosur nje infopoint, ku publiku mund të marrë informacion në kohë reale për çështjen për të cilën është i interesuar dhe shortin. Infopoint ka qenë funksional edhe gjatë vitit 2021
- Në përputhje me nenin 7 të ligjit nr.119/2014 “Për të Drejtën e Informimit” është përditësuar programi i transparencës për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Gjirokasër. Informacioni i bërë publik në këtë program, synon të bëjë transparencën e veprimtarisë së punës së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokasër, nëpërmjet pasqyrimit të tij në portalin www.gjykata.gov.al.
- Gjykata ka publikuar në faqen e saj elektronike zyrtare informacionin dhe dokumentacionin e disponuar prej saj, të parashikuar nga ligji. Në kuadër të ligjit për të drejtën e informimit gjatë këtij viti janë trajtuar nga gjykata disa kërkesa për informim. Për të gjitha kërkesat, brenda afatit ligjor është vënë në dispozicion informacioni i kërkuar pa cënuar të drejtat e tjera, siç është mbrojtja e të dhënave personale.
- Në raport me median, gjykata ka trajtuar kërkesat për informacione apo ndjekje të seancave gjyqësore për çështje për të cilat kanë patur interes publik. Në këto raste media apo gazetarët personalisht janë informuar me anë të njoftimeve. Në fund të vitit 2019 është caktuar nga KLGJ gjyqtari i medias, i cili është gjyqtar në Gjykatën e Apelit Gjirokastër, Z.Enton Dhimitri dhe mbulon gjykatat e rretheve Gjirokasër, Sarandë dhe Përmet. Koordinimi me informacionet e kërkuara dhe të dhëna nga ana jonë është periodik dhe i suksesshem.
- **Zyra e Marrëdhënieve me Publikun dhe Median**
 - Zyra e Marrëdhënieve me Publikun dhe Median është bërë pjesë e strukturës dhe organikës në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Gjirokastër, në qershor të vitit 2021. Kjo zyrë ushtron përgjegjësitë dhe kompetencat nga Punonjësja për Marrëdhëniet me Publikun dhe Median, në bashkëpunim me Drejtuesin e Institucionit, Kancelarin dhe Gjyqtarin e Medias. Mbështetur tek një nga parimet kryesore të punës sonë, atë të rritjes së besueshmërisë tek publiku, shërbimet e ofruara nga kjo zyrë, kanë qenë në përputhje dhe në respektim të Ligjit Nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, si dhe Ligjit Nr. 9887, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”.
 - Bashkëpunimi me publikun dhe median është trajtuar me përparësi duke i dhënë rëndësinë e duhur, jo vetëm komunikimit të drejtpërdrejtë, por duke krijuar akses në gjykatë përmes; koordinimit me shërbimet e administratës së gjyqësorit, Kryesekretarisë, shërbimeve online në faqen zyrtare të gjykatës, adresës elektronike zyrtare (e-maili elektronik për kërkesat/ankesat), shërbimit postar për shkresat zyrtare /kërkesat për informacion). Në faqen zyrtare Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastër disponon informacion të aksesueshëm dhe të përditësuar për publikun, median dhe palët e treta.

- NËpërmjet kësaj zyre janë kryer të gjitha komunikimet me gazetarët e mediave ndërkombëtare, kombëtare, lokale, si të medias vizive dhe të shtypit të shkruar. Informacioni i nevojshëm iu është dhënë gazetarëve në formë të shkruar në rastet, kur kërkimi i tyre është parashtruar me shkrim, në formatin elektronik, si dhe përmes shërbimit postar. E njëjta praktikë pune është ndjekur edhe në rastet kur informacioni është kërkuar nga përfaqësues të organizatave, shoqatave, rrjeteve sociale, studentë të Shkollës së Magjistraturës, qytetarë, të cilëve iu është ofruar në kohë materiali i kërkuar.
- Për vitin 2021 rezultojnë të regjistruara gjithsej 35 kërkesa në Regjistrin e Kërkesave dhe Përgjigjeve, duke specifikuar se janë regjistruar ato kërkesa që kanë ardhur në respektim të nenit 11, të Ligjit Nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”, por pranë zyrës së Kryesekretarisë dhe përmes email-zyrtar janë regjistruar një numër shumë herë më i madh shkresa/kërkesa që janë trajtuar në kohë nga zyrat përkatëse.
- Duke qenë se Programi i Transparencës është vlerësuar si mjaft i rëndësishëm për veprimtarinë e gjykatës, perceptimin e drejtë të punës në këtë institucion, imazhin dhe mbështetjen e vlerave themelore të sistemit gjyqësor, I është kushtuar vëmendje çdo sugjerimi, kërkesë apo orientimi në funksion të përmirësimit të punës në këtë drejtim.
- Sigurimi i një publiku dhe medie të informuar në një kohë sa më të shpejtë, mbetet një nga sfidat kryesore për punonjësen e Zyrës së Marrëdhënieve me Publikun dhe Median, pasi përmes informimit dhe vendosjes së komunikimit mund të ndryshojmë qasjen e publikut me gjyqësorin, gjyqtarëve me median, pakësimin e problematikave dhe rritjen e besueshmërisë në punën tonë.

5. Çështjet e infrastrukturës, ruajtjes dhe sigurisë në gjykatë.

Në vitin 2021 janë marrë masa për përmirësim në drejtim të sistemit të monitorimit të lëvizjeve në ambientet e brendshme të gjykatës. Gjithashtu janë marrë masa për monitorimin dhe mirëfunksionimin e sistemit të integruar për mbrojtjen nga zjarri, përmbytjet dhe rreziqe të tjera. Po ashtu janë hartuar rregullat për garantimin e rendit dhe sigurisë në gjykatë.

Pranë kësaj gjykate ka përfunduar instalimi i të gjithë elementëve të sigurisë, sistemi i kamerave , sistemi i hyrjes me kartë, sistemi i fikjes së zjarrit dhe sistemi detektimit për personat që hyjnë në gjykatë .

Gjatë vitit 2021 kanë funksionuar normalisht 4 salla gjykimi, të pajisur me kompjuter, mixer për regjistrimin audio, dhe monitorë TV (për rastet e seancave kur duhen të shfaqen video të dorëzuar si provë nga palët pjesëmarrëse).

Kushteve e godinës së gjykatës garantojnë plotësisht elementët e sigurisë përsa i përket lëvizjes së veçantë të gjyqtarëve e të palëve.

6. Administrimi i fondeve publike për vitin 2021

Sipas Plan – Buxhetit të vitit 2021, Gjykata ka kryer shpenzimet për paga, Sigurime Shoqërore, Shpenzime Operative dhe Investime. Në shpenzimet e kryera janë pasur parasysh çeljet e fondeve sipas zërave të shpenzimeve.

Në fund të vitit është kryer rakordimi përfundimtar i shpenzimeve të vitit ushtrimor 2021, me Degën e Thesarit dhe është bërë raportimi i tyre në KLGJ.

Zyra e Buxhetit ka realizuar më së miri zërat e përcaktuar në buxhetin e gjykatës sonë. Realizimi i shpenzimeve operative ka qenë në masën në 98 % për vitin 2021.

ARTIKULLI 602 “ Shpenzime Operative” në 000/lekë

Plani 6.500 mijë Fakti 6.372 mijë lekë Realizimi në 98 %

Në fund të vitit 2021 Gjykata Rrethit Gjirokastrë ka fatura të palikujduara që i përkasin detyrimeve për muajin Dhjetor 2021 në masën si më poshtë:

Tabela. 25

Nr	Emërtimi	Vlera
1	Llogari të Pagueshme	2.581.866
-	Detyrime për paga e sigurime	2.337.331
	Llog 421-paga	1.612.978
	Llog 431-tatim page	223.893
	Llog 435- Sig shoqërore	390.771
	Llog 436- sig shëndetsore	69.912
	Llog 438- sig suplementar	39.777
	Furnitor (401)	244.535
-	UK sha	11.717
-	Alb Telekom Albania	4.884
	FSHU	182.834
	Detyrim i trashëguar për 401 nga Godina Përmet për servis fotokopje	45.100

Në zërin investime Gjykatës së Rrethit Gjirokastrë për vitin 2021 nga buxheti i shtetit ju akordua një fond në shumën 1.170 mijë lekë për blerje pajisje elektronike (komjuter 11 copë dhe printer 1 copë) për gjyqtar ,administratë,

Argumentimi i kërkesës së bërë në (PBA 2021-2023) , kemi marrë në konsideratë gjendjen e pajisjeve ekzistuese, amortizimin si dhe parametrat teknikë, me qëllim mbështetjen e programeve të instaluar në to, të diferencuara sipas posteve të punës.

Plani fillestar 1.170 mijë leke , Plani i rishikuar 890 leke , Fakti 882 mijë leke viti 2021 në % 99% , e buxhetit të rishikuar .

Me shkresë NR.245 PROT, Datë 21.05.2021 Lënda: Kërkesë për paksim fondi në Artikullin 231 Investime për Gjykatën e Rrethit Gjirokastrë drejtuar KLGJ -së është bërë dhe pakësimi i fondit në masën 280 mijë lekë.

Tabela.26

Ent Qev	Min Linjës	Kod Inst	Emër institucioni	Kap	Prog	Llog ekon	Kod deg Thesari	Kod produkti	Shuma në lekë	Emërtim produkti
PAKËSOHET										
001	29	1029019	Gjykata Rrethit Gjirokastrë	01	03310	2310000	1111	M290072	288,000	Pajisje elektronike
Totali pakësimeve progresive 03310 llogaria ekonomike 231									288,000	

Sipas komisionit të vlerësimit këto kompjutera janë në gjendje të mirë pune dhe mund të përdoren në Qendrën Terapeutike të Zhvillimit të Fëmijëve, si dhe në Bashkinë Gjirokastrë me transferimin kapital pas miratimit nga KLGJ të procedurës dërguar në Dhjetor 2021.

Duke qenë se ne si gjykatë punojmë me programe të avancuara që janë të instaluar, këta kompjutera janë zëvendësuar nga blerje të reja në vitin 2021.

Sipas komisionit tonë të vlerësimit këta kompjutera janë në gjendje të mirë pune dhe mund të përdoren në Qendrën Terapeutike të Zhvillimit të Fëmijëve nën juridiksionin e Këshillit të Qarkut Gjirokastrë, si dhe në Bashkinë Gjirokastrë (në zyrat e administratës së Drejtorisë Arsimore)

Të ardhurat

Gjykata e Rrethit Gjirokastrë në ushtrimin e aktivitetit të saj, realizon të ardhura nga shitja e Pullave Tatimore dhe të ardhura nga 1% e kërkesë padive.

Për vitin 2021 të ardhurat sipas zërave paraqiten si vijon:

Tabela.27

Nr	Emërtimi	Vlera
1	Të Ardhura shitje Pulla Tatimore	222.900
2	Të Ardhura nga 1% akt padi	149.684
	Totali	372.584

Sipas Akt-Rakordimit vjetor 31.12.2021 me Degën e Thesarit, pjesa që i takon institucionit nga këto të Ardhura është 10% e taksës së pullës + 1% kërkesë padi, në vlerë 372.584 lekë . Kjo vlerë është përdorur në masën 272.960 lekë për shpenzime për investime., duke plotësuar disa nevoja bazë të institucionit si blerje kondicioner 4 copë dhe konkretisht , për zyrën e Arkivës 12 BTU, zyrë sekretare 12 BTU , arkivën kati I parë 18 BTU dhe sallë gjyqi 18 BTU .

7. Marrëdhëniet me institucionet e tjera.

- Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë ka bashkëpunuar në mënyrë të vazhdueshme me institucionet si Këshilli i Lartë Gjyqësor, Ministria e Drejtësisë dhe Shkolla e Magjistraturës me qëllim plotësimin e kërkesave dhe marrjen e masave për trajtimin e ankesave, kryerjen e procesit të hartimit dhe administrimit të statistikave dhe ndjekjen e trajnimit vazhdues të gjyqtarëve dhe administratës gjyqësore. Edhe në vitin 2021 gjyqtarët kanë ndjekur trajnimet vazhduese të organizuara kryesisht nga Shkolla e Magjistraturës.
- Në vitin 2021 janë zhvilluar disa takime dhe është rritur bashkëpunimi me institucionet si Komisaritet e Policisë dhe Bashkia Gjirokastrë, kryesisht për përmirësimin e procedurave që lidhen me plotësimin, paraqitjen dhe shqyrtimin e urdhrave të mbrojtjes, komunikimit sa më të shpejtë të vendimeve gjyqësore me qëllim zbatimin e menjëhershëm të tyre.

- Edhe në vitin 2021, është bërë e mundur përfaqësimi i viktimave me avokat falas në rastet kur e kërkojnë. Kjo në sajë të bashkëpunimit me Dhomën Vendore të Avokatisë Gjirokastër në bazë të listës së avokatëve që kanë pranuar të ofrojnë ndihmë juridike falas për viktimat e dhunës në familje në gjykimet për lëshimin e urdhrave të mbrojtjes. Po ashtu, është ndjekur praktika e mëparshme për përcaktimin e listës së avokatëve.
- Problematika e evidentuar më parë në lidhje me Dhomën e Avokatëve Gjirokastër, për sa i përket përcaktimit të avokatëve të gatshëm për t'u caktuar si mbrojtës kryesisht në çështjet penale, vazhdon edhe për vitin 2021 pasi nuk është vendosur rregullisht në dispozicion lista apo grafiku përkatës .
- Në raport me organin e Prokurorisë bashkëpunimi vlerësohet shumë i mirë, pasi nuk janë shfaqur problematika që të cenojnë veprimtarinë e rregullt gjyqësore, në aspekte të respektimit të solemnitetit të gjykimit, mosparaqitjes në seancë apo paraqitjes me vonesë, në paraqitjen me vonesë të kërkesave urgjente për vlerësimin e arrestimeve në flagrancë, urdhrave të ndalimit, etj. Po ashtu, bashkëpunimi vlerësohet shumë i mirë, edhe me institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale. Është për t'u vlerësuar se ky institucion ka pranuar pa problem marrjen e njoftimeve qoftë edhe në formë elektronike, duke siguruar shoqërimin në kohë të personave, si dhe në mënyrë të sigurt.
- Me Policinë e Shtetit, përgjithësisht bashkëpunimi ka qenë shumë i mirë në lidhje me marrjen e masave nga ana e tyre për shoqërimin në kohë dhe në mënyrë të sigurt, të personave të arrestuar ose të ndaluar, njoftimin dhe kryerjen e detyrave të tjera në rastet e “urdhrave të menjëhershëm të mbrojtjes”, etj.
- Në lidhje me shoqërinë “Posta Shqiptare” sh.a., siç u parashtrua më sipër, janë shfaqur problematika, në lidhje me cilësinë dhe shpejtësinë e ofrimit të shërbimit për realizimin e njoftimeve, por kemi një përmirësim në raport me vitin paraardhës.

V. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

- Rritja e standartit të cilësisë së gjykimeve mbetet një nga prioritetet kryesore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër.
- Edhe pse mungojnë aktet normative që të përcaktojnë ngarkesën maksimale të çështjeve që mund të përballojë një gjyqtar, në mënyrë që të ushtroj normalisht funksionin, vlerësohet se gjatë këtij viti gjyqtarët kanë pasur një ngarkesë të lartë pune në raport me vitin paraardhës.
- Një aspekt shumë i rëndësishëm është dhe përmirësimi i veprimtarisë administrative të gjykatës. Në këtë kuadër shihet me rëndësi rritja e nivelit profesional të administratës të gjykatës, etikës në komunikim si me publikun edhe me gjyqtarët, përkushtimi i tyre në punë, kryerja e detyrave me korrektesi dhe shpejtësi. Po aq e rëndësishme për veprimtarinë e administratës gjyqësore është dhe përcaktimi i qartë i kufijve të ndihmës ligjore, duke mos e ngatërruar atë me shërbimet që duhet të ofrohen nga administrata apo dhe me informacionin që duhet të jepet prej saj. Shërbimet e ofruara duhet të jenë jo vetëm në cilësi, por edhe të shpejta për të respektuar të drejtat e palëve

në gjykim. E rëndësishme në këtë drejtim është dhe organizimi i trajnimeve të stafit administrativ për aspekte të ndryshme të veprimtarisë, e cila do të çonte në përmirësim të dukshëm të cilësisë së shërbimeve që ofrohen nga kjo administratë.

- Në përfundim të kësaj analize si prioritet do të jetë angazhimi i gjyqtareve dhe administratës së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë për të pasur si objekt kryesor të punës së tyre në vitin 2022 zbatimin e ligjit, dhënien e drejtësisë në përputhje me legjislacionin në fuqi, me shpejtësi dhe transparencë në mënyrë që drejtësia jo vetëm të bëhet, por edhe të duket duke siguruar standartin më të lartë në garantimin e lirive dhe të drejtave të qytetarëve.

Gjirokastrë, më 15.04.2022

ZV/KRYETAR I GJYKATËS

ARBEN DOSTI